



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 22

Tiranë – E enjte, 10 shkurt 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 9.2.2022	Për disa ndryshime (amendimi i tretë) në tekstin e marrëveshjes për prodhimin e furnizimin, nga dhe ndërmjet <i>Pfizer Export B.V.</i> , Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.....
	2715
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 68, datë 2.2.2022	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Shishtavec (Kukës)–Krushevë (Dragash).....
	2715
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 80, datë 9.2.2022	Për emërim në detyrë.....
	2717
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 101, datë 9.2.2022	Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2022.....
	2717



AKT NORMATIV
Nr. 1, datë 9.2.2022

PËR DISA NDRYSHIME (AMENDIMI I TRETË) NË TEKSTIN E MARRËVESHJES PËR PRODHIMIN E FURNIZIMIN, NGA DHE NDËRMJET PFIZER EXPORT B.V., MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRI TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Miratimi i tekstit të disa ndryshimeve (amendimi i tretë)

Miratimin e tekstit të disa ndryshimeve (amendimi i tretë) në marrëveshjen për prodhimin e furnizimin, nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.*, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 2

Detyrimet e organeve shtetërore

1. Ndryshimet në tekstin e marrëveshjes për prodhimin e furnizimin, nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.*, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, bashkëlidhur këtij akti normativ, për shkak të sekretit tregtar, nuk do të publikohen në asnjë *website* të institucioneve apo në Fletoren Zyrtare.

2. Të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e mendimit, të miratimit apo që janë pjesë e

procesit kanë detyrimin të mos bëjnë publike ndryshimet në marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ apo pjesë të saj.

3. Detyrimet e organeve shtetërore dhe përjashtimet nga detyrimet për furnizimin e vaksinës *anticovid*, të përcaktuara në aktin normativ nr. 1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, janë të njëjta edhe për ndryshimet (amendimi i tretë) në tekstin e marrëveshjes për prodhimin e furnizimin, nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.*, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, sipas kushteve të tekstit të marrëveshjes, që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 68, datë 2.2.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR SHISHTAVEC (KUKËS)–KRUSHEVË (DRAGASH)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për hapjen e pikës së



përbashkët të kalimit kufitar Shishtavec (Kukës)–Krushevë (Dragash), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

MARRËVESHJE NDRYSHUESE
E MARRËVESHJES NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT
TË KALIMIT KUFTAR
KRUSHEVË (DRAGASH)
–SHISHTAVEC (KUKËS)

Këshilli i Ministrave i Republikës të Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (në vijim “palët nënshkruese”), më 16 prill 2013 kanë lidhur Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar Krushevë (Dragash)–Shishtavec (Kukës). Nisur nga vullneti i mirë për të forcuar dhe për të avancuar më tej bashkëpunimin, zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor, palët hynë në ndryshimin numër një të kësaj Marrëveshjeje, i cili bën ndryshimin në kategorizim të pikës së përbashkët të kalimit kufitar nga kategoria C në kategorinë B.

Palët kanë rënë dakord të ndryshojnë Marrëveshjen, si më poshtë:

Neni 1

Neni 1 i Marrëveshjes ndryshohet, si në vijim:

“Palët bien dakord për të ngritur nivelin e organizimit dhe të funksionimit të Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar Shishtavec–Krushevë (në vijim “PPKK”) në kategorinë B.

PPKK-ja do të punojë në orar 24/7 për trafikun kufitar të udhëtarëve, mjeteve dhe mallrave jokomerciale.

Objekti i ri i PPKK-së do të ndërtohet në territorin e Republikës së Shqipërisë, në vendin e quajtur Shishtavec.”.

Neni 2

Neni 2 të Marrëveshjes bazë i shtohet një paragraf i ri, si në vijim:

“Ngarkohet Komiteti i Përbashkët i Ekspertëve (në vijim “KPE”) që të caktojë vendndodhjen e objektit të përkohshëm të PPKK-së, e cila do të funksionojë deri në përfundimin e ndërtimit të objektit të ri të PPKK-së.”.

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si në vijim:

Palët bien dakord në zbatim të kësaj Marrëveshjeje dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet KPE-së, të nënshkruajnë protokolle të reja zbatimi, në të cilat do të përcaktohen çështjet teknike, financiare dhe të organizimit, që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe me funksionimin e PPKK-së.

Neni 4

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e të dyja palëve nënshkruese, përmes shkëmbimit të notave verbale.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e marrjes, përmes kanaleve diplomatike, të njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin palët vënë në dijeni njëra-tjetrën se kanë përmbushur të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacionet e shteteve të tyre, për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në Elbasan, më 26 nëntor 2021, në dy origjinale, secila në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, të gjitha tekstet njëlloj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje mbi interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, do të ketë përparësi teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Z. Bledar Çuçi
Ministër i Brendshëm

PËR QEVERINË E REPUBLIKË
SË KOSOVËS
Z. Xhelal Sveçla
Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme

**VENDIM****Nr. 80, datë 9.2.2022****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Artemis Malo emërohet zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****VENDIM****Nr. 101, datë 9.2.2022**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË
MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË
FINANCIMIT NGA FONDI I
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË E
ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 3, e 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2022 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëri “Transferte në buxhetet familjare” (llogaria ekonomike 606), të përdoret, për:

a) rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve bujqësore në mjedise të mbrojtura, të bimëve mjekësore e aromatike, të prodhimeve blegtorale, duke ulur kostot e prodhimit, nëpërmjet pagesave për sipërfaqe të kultivuar, si dhe për kafshë të matrikulluara;

b) shtimin e sipërfaqeve të serrave për mbjelljen e perimeve;

c) certifikimin e produkteve bujqësore dhe fermave organike;

ç) ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore dhe tregjeve të kafshëve të gjalla në disa bashki të vendit;

d) përmirësimin e eficiencës energjetike dhe përshtatjen e kapaciteteve të peshkimit me burimet peshkore;

dh) mbështetjen me naftë për bujqësinë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore;

e) mbështetjen për ngritjen e një skeme kombëtare trajnimit në bujqësi dhe ngritjen e Qendrës së Ekselencës dhe Inovacionit të Sistemeve Prodhuese, në Universitetin Bujqësor të Tiranës, për trajnimin dhe transferimin e njohurive në fushën e bujqësisë e të zhvillimit rural, si dhe mbështetje për automatizimin e digjitalizimin e proceseve të punës në nivel ferme.

2. Masat e mbështetjes dhe masa e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë, si më poshtë vijon:

2.1 Bujqësia – Serra

a) Mbështetje për fara/fidanë dhe *input-e* të tjera me 200 000 (dyqind mijë) lekë për ha për sezon dhe jo për më shumë se 2 sezone, për kultivimin e perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermerë individualë ose grup-fermerësh, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për aplikant.

b) Për ndërtimin e serrave diellore të reja për prodhimin e perimeve me sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 5 (pesë) ha për subjekt, përfshirë edhe instalimin e sistemit të ujitjes. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë për ha.

c) Mbështetje për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë/ha, për fermerë individualë ose grup-fermerësh, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë për aplikant.

ç) Fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë, 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, vitin e tretë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) për fermë të certifikuar.



d) Implementimi dhe certifikimi global GAP, në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore,;

i. por jo më shumë 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, në sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha;

ii. por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 ha në fushë të hapur.

2.2 Blegtoria dhe peshkimi

a) Për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermat me jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë, por jo më shumë se 360 000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për subjekt, ndërsa për fermat me jo më pak se 10 (dhjetë) krerë lopë, në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt.

b) Mbarështim i bletarisë me 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për ferma me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje, por jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë) mijë lekë për subjekt.

c) Për blerjen e anijeve të peshkimit tregtar profesional, që zëvendësojnë anijet ekzistuese. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore të blerjes, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për subjekt peshkimi, në rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 11, të nenit 30, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin” të ndryshuar.

ç) Për rinovimin infrastrukturës së anijes së peshkimit. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore të blerjes, por jo më shumë se 7 250 000 (shtatë milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë për anije peshkimi të pajisur me leje të vlefshme peshkimi tregtar dhe jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për subjekt. Rinovimi i anijes së peshkimit përfshin:

i. blerjen dhe instalimin e motorit kryesor, por jo më shumë se 4 000 000 (katër milionë) lekë;

ii. blerjen dhe instalimin e motorit ndihmës (gjeneratori detar), por jo më shumë se 2 000 000 (dy milionë) lekë;

iii. blerjen dhe instalimin e vinçit të anijes, por jo më shumë se 1 250 000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

2.3 Tregje të produkteve bujqësore dhe të kafshëve të gjalla

a) Mbështetje për ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore dhe/ose tregjeve të kafshëve të gjalla për shoqëritë aksionare me kapital 100% shtetëror, në vlerën jo më shumë se 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, nëpërmjet transferimit të fondit nga llogaria ekonomike 606 në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transferta të brendshme”. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) ekzekuton transferimin e fondit përkatës të bashkia përkatëse, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e këtij fondi.

2.4 Inovacione dhe digjitalizim në bujqësi

a) Mbështetje për ngritjen e një skeme kombëtare trajnimit në bujqësi dhe ngritjen e Qendrës së Ekselencës dhe Inovacionit të Sistemeve Prodhuese, në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), në bashkëpunim me një nga universitetet evropiane, në vlerën deri në 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, nëpërmjet transferimit të fondit nga llogaria ekonomike 606 në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transferta të brendshme”. AZHBR-ja ekzekuton transferimin e fondit përkatës tek UBT-ja, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e këtij fondi.

b) Mbështetje për automatizimin dhe digjitalizimin e proceseve të punës në fermë. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë për subjekt.

2.5 Naftë për bujqësinë

2.5.1 Mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi, në vlerën deri në 950 000 000 (nëntëqind e pesëdhjetë milionë) lekë.

2.5.2 Subjektet përfituese mbështeten me sasi naftë falas në barasvlerë të lehtësimit fiskal të naftës që përdoret për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore, sipas kritereve dhe masës së përfitimit, të përcaktuara në këtë vendim.

2.5.3 Kulturat bujqësore/grup-kulturat, normativat e konsumit të naftës dhe sasia përkatëse e naftës që përfitohet falas janë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij. Si çmim referencë për naftën do të merret çmimi i botuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i Agjencisë së Prokurimit Publik, nr. 5, datë 7.2.2022 (rubrika “Të dhëna për karburantet”,



me burim informacioni Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

2.5.4 Subjektet përfituese duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të kenë tokë bujqësore në pronësi dhe ose në përdorim, të provuar me dokumentacionin përkatës;

b) madhësia totale e fermës duhet të jetë me sipërfaqe jo më pak se 0.4 ha, ndërsa madhësia e parcelave me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha.

2.5.5 Aplikimi për të përfituar nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë bëhet *online* në portalin *e-Albania*, me vetëdeklarim.

2.5.6 Përfitimi i sasisë së naftës falas për sipërfaqen që kultivohet, është, si më poshtë vijon:

a) 100% e sasisë për subjektet me sipërfaqe deri në 10 ha, sipas përlogaritjeve të bëra referuar aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) subjektet me sipërfaqe mbi 10 ha, për sipërfaqen deri në 10 ha, përfitojnë sasinë sipas përcaktimit të shkronjës “a” të kësaj pike, ndërsa për pjesën tjetër mbi 10 ha përfitojnë sasinë e naftës me normativë të reduktuar. Normativa e reduktuar përlogaritet bazuar në nevojat për naftë të subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha, por jo më shumë se normativa e lejuar, si dhe në sasinë e mbetur të naftës në dispozicion, pasi janë plotësuar nevojat deri në 10 ha të të gjitha subjekteve, që janë kualifikuar si përfitues.

2.5.7 Aplikimet i nënshtrohen procesit të verifikimit/kontrollit administrativ dhe për aplikimet fituese kryhet kontrolli në terren. Procesi i kontrollit në terren kryhet pas shpërndarjes së naftës te subjektet përfituese.

2.5.8 Procesi i kontrollit në terren kryhet pas shpërndarjes së naftës te subjektet përfituese:

a) për të vlerësuar përputhshmërinë e vetëdeklarimeve me situatën reale dhe shmangien e lejuar të faktit të verifikuar të kulturave dhe të sipërfaqes së kultivuar, në raport me naftën e tërhequr, e cila të jetë jo më e madhe se 20%;

b) në jo më pak se 10% të subjekteve përfituese, përfshirë kontrollin e gjitha subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha.

2.5.9 Çdo subjekt, që përfiton nga skema e mbështetjes me naftë për bujqësinë, me shmangie më të madhe se 20%, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të nën pikës 2.5.8 të këtij vendimi, ose me deklarime/dokumente të pasakta, përjashtohet për 3 (tre) vjet nga e drejta e përfitimit

prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit.

Referuar paragrafit të parë të kësaj pike, subjektet me status fizik dhe juridik shpallen edhe debitorë për vlerën e përfituar në mënyrë të padrejtë.

2.5.10 Nafta për bujqësinë do të shpërndahet nga operatorët furnizues të kontraktuar në bazë të përzgjedhjes, sipas procedurave ligjore prokuruese kuadër, nëpërmjet pikave të tyre të shpërndarjes në të gjithë vendin, ku fermerët paraqiten me kartën individuale, në të cilën është hedhur sasia e naftës që ka të drejtë të tërheqë fermeri përkatës.

2.5.11 Procedura e prokurimit për blerjen dhe shpërndarjen e naftës për përdorim nga fermerët realizohet, sipas parashikimeve të vendimit nr. 82, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”, të ndryshuar.

2.5.12 Likuidimi i pagesave për furnizuesit e kontraktuar të naftës bëhet në përputhje me sasinë e naftës së shpërndarë te përfituesit.

3. Përfitues për masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë fermerët, personat fizikë, personat juridikë, SHBB-të dhe UBT-ja.

4. Përfituesve të financimit nga masat e mbështetjes së investimeve, sipas përcaktimit në shkronjën “b”, të pikës 2.1, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 2.2, dhe në shkronjën “b”, të pikës 2.4, të këtij vendimi, pas lidhjes së kontratës u paguhet paraprakisht deri në 50% të masës së financimit të kontraktuar, kundrejt garancisë së pagesës së lëshuar nga shoqëri sigurimi dhe/ose banka.

5. Kriteret, procedurat dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

6. Nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022, të përdoret shuma:

a) deri në 37 600 872 (tridhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë, për pagesën e vlerës së palikuiduar, për subjektet e shpallura fituese nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, në zbatim të vendimit nr. 1102, datë 24.12.2020, të Këshillit të



Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2021”.

b) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë detyrime, për pagesat e normës së interesave bankare për kontratat e lidhura.

7. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1
KULTURA BUJQËSORE/GRUP-KULTURASH, NORMATIVAT E KONSUMIT
TË NAFTËS DHE SASIA E NAFTËS QË PËRFITOHET FALAS

Nr. / Kod i	Kultura bujqësore/ grup-kulturash	Normativa e konsumit të naftës të punimeve të mekanizuar a	Sasia e naftës që përfitohe t falas*	Specifikime
		L/ha	L/ha	
A	Bimë arash			
A.1	Grupi 1	190	101	Pranverore (misër, fasule, luledielli, sojë, sorgum)
A.2	Grupi 2	130	69	Të lashta (grurë, tërshërë, thekër, elb), Foragjere njëvjeçare, industriale (patate, duhan, panxhar, pambuk)
A.3	Grupi 3	90	48	Foragjere shumëvjeçare, Bimë aromatike-mjekësore
B	Dru frutorë			
B.1	Mollë	190	101	
B.2	Dru frutorë, të tjera	160	85	Të gjitha llojet e frutave, ulli, agrume dhe vreshta
B.3	Arrore	140	75	Arra, bajame, lajthi dhe gështenja (të kultivuara)
B.4	Prodhim i fidanëve frutorë, agrume e arrore	170	91	Për të gjithë fidanët e bimëve farore, bërthamore dhe arrore
C	Perime			
C.1	Perime fushe sezoni 1	150	80	Të gjitha llojet e perimeve përfshirë shalqi, pjepër, luleshtrydhe
C.2	Perime fushe sezoni 2	120	64	Të gjitha llojet e perimeve
C.3	Perime serre sezoni 1	170	91	Të gjitha llojet e perimeve
C.4	Perime serre sezoni 2	140	75	Të gjitha llojet e perimeve

* Nga çmimi mesatar vjetor i naftës, zbriten:

- Akciza	37 lekë/L
- Taksa e qarkullimit	27 lekë/L
- Taksa e karbonit	3 lekë/L

Nëntotal	67 lekë/L
TVSH respektive (20%)	13,4 lekë/L

TOTAL 80,4 lekë/L

**** Koefficienti i përfitimit të naftës falas mbi normativë = 80,4 lekë/15l¹ *100 = 53%**

¹ Çmimi referencë për naftën për vitin 2022 nga Buletini Nr. 15 i Agjencisë së Prokurimit Publik, datë 7.2.2022.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 48 lekë

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*